



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages	02
Nr. Prot. Bi. Prot. Prot. No.	01-4516/13
Data Datum Date	30.12.2013
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 1.1), nenin 5 (paragrafi 1.5) dhe nenin 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 (paragrafi 11 dhe 12) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 18.12.2013, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-3039/13, për z. Aleksandar Janicevic – ish Anëtar i Bordit në Radio Televizionin e Kosovës, për arsye se i njëjti tashmë nuk e ushtron funksionin e zyrtarit të lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-3039/13, për z. Aleksandar Janicevic – ish Anëtar i Bordit në Radio Televizionin e Kosovës, dhe njëkohësisht pronar në biznesin privat P.P. “Inter - Commerce”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Në këtë rast, ish zyrtari i lartë z. Janicevic, së pari është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit lidhur me funksionin e tij publik.

Pas pranimi të kësaj shkrese, zyrtari në fjalë, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet. Në këtë takim, ai na ka informuar se nuk e ushtron më funksionin e zyrtarit të lartë, përkatësisht Anëtarit të Bordit në Radio Televizionin e Kosovës.

Pas kësaj, zyrtarët e Radio Televizioni i Kosovës, me kërkesën e Agjencisë, kanë dërguar informacionin zyrtar në të cilën vërtetohet se z. Janicevic nuk e ushtron më këtë funksion.

Prandaj, duke pasur parasysh këto të dhëna, konstatojmë se gjendja e mundshme e konfliktit të interesit është shmangur.

Andaj u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

U skladu sa članom 11(stav1.1),članom 5(stav1 tačka 1.5), člana 18(stav 10 i 11) Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije kao i člana 24(stav 11) Pravilnika o Radu Agencije protiv Korupcije, Direktor Agencije protiv Korupcije, dana 18.12.2013, donosi:

:

O D L U K U

I. Obustavlja se slučaj pod br. AKK – 03-3039/13, za g.Aleksandar Janičijević-Bivšeg člana Upravnog Odbora Radio Televizije Kosova, iz razloga što isti ne obavlja funkciju visokog javnog zvaničnika.

. II. Slučaj se može ponovo otvoriti u svako doba u slučaju pojavljivanja novih okolnosti.

Obrazloženje

I. Slučaj br.AKK-03-3056-13, je započet pod sumnjom za Sukob interesa u toku obavljanja javne funkcije, za g.Aleksandar Janičijević-bivšeg člana Upravnog Odbora Radio Televizije Kosova,i istovremeno vlasnik privatnog biznisa P.P.”Inter-Commerce”. Slučaj je obrađen po predviđenoj zakonskoj proceduri, za sprečavanje sukoba interesa tokom obavljanja javne funkcije (Zakon br.04/L-051).

U ovom slučaju, bivši visoki zvaničnik, je prvo službenim pismom obavešten o pokretanju procedure za kontrolu stanja mogućeg sukoba interesa u vezi njegovog obavljanja javne funkcije.

Nakon prijema dopisa, pomenuti zvaničnik, je došao na sastanak sa službenicima Agencije i njemu je objašnjeno u kakvoj se situaciji nalazi. Na ovom sastanku on nas je obavestio da više ne obavlja funkciju visokog zvaničnika, konkretno Člana Upravnog Odbora Radio Televizije Kosova.

Nakon ovoga, na zahtev Agencije, dobili smo od Rado Televizije službenu informaciju kojom se potvrđuje da g.Janičijević više ne obavlja pomenutu funkciju.

Dakle, uzimajući u obzir ove podatke, konstatujemo da je izbegnuta situacija mogućeg sukoba interesa.

Zbog toga je odlučeno kao u dispozitivu ove odluke

II. U skladu sa članom 18 stav 11 Zakona br.03/L-159 za Agenciju protiv Korupcije, Agencija može ponovo otvoriti slučaj u svako doba u slučaju pojavljivanja novih okolnosti

Odluka se dostavlja :

- Visokom javnom zvaničniku
- Direktor DSK
- G./Gđi (odgovornom službeniku)

Direktor Agencije protiv Korupcije

Hasan Preteni

